

# Vlerësimi i Opsioneve të Dialogut të Brendshëm të Serbisë mbi Kosovën

## Hyrje

Pas më shumë se tre muajve nga përfundimi i dialogut të brendshëm të Serbisë mbi Kosovën, inicuesi i dialogut, Presidenti i Serbisë Aleksandër Vučić, ende nuk e ka prezentuar platformën e tij të paralajmëruar për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Platforma është dashur të ketë për bazë rezultatin e dialogut. Presidenti Vučić thotë që platforma ende nuk është e gatshme dhe se nuk e di se kur do ta bëjë publike atë. As qeveria nuk ka lëshuar ndonjë konkluzion zyrtar, përveç disa zyrtarëve të cilët theksuan se shumica e pjesëmarrësve në dialog kanë qenë pro ruajtjes së *status kuo-së*.

Menjëher pas fillimit të dialogut të brendshëm, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG) ka organizuar pesë takime lidhur me këtë çështje.<sup>1</sup> Takimi i fundit – një punëtori – është mbajtur më 27 qershor, 2018. Me synimin e vlerësimit të njëmbëdhjetë opsioneve të dala nga dialogu i brendshëm dhe identifikimit të atyre më të realizueshme, CIG mbledhi një numër ekspertësh nga Serbia në Beograd. Nga të njëmbëdhjetë opsionet,<sup>2</sup> pjesëmarrësit në punëtori identifikuan katër si më të realizueshme dhe vlerësuan përparësitë dhe të metat për secilin opsion. 1. *Status kuo*; 2. *Ndarja apo shkëmbimi i territoreve në baza etnike*; 3. *Njohja de-juro*; dhe 4. *Njohja de-fakto*.

Punëtorja është mbështetur nga Departamenti Zvicërran për Punë të Jashtme dhe Fondacioni për Shoqëri të Hapur. Igor Novaković, përfaqësuesi i CIG-ut në Serbi, ka hartuar këtë raport. Jemi munduar të jemi të saktë dhe të balansuar në përmbledhjen e diskutimeve, dhe kërkojmë mirëkuptim nga pjesëmarrësit këndvështrimet e të cilëve mund të mos jenë pasqyruar në tërësi në këtë raport të shkurtër, gjë për të cilën CIG merr përgjegjësi të plotë. Këto konkluzione nuk bazohen në konsensus dhe jo domosdoshmërisht paraqesin opinionin e secilit pjesëmarrës. Nga pjesëmarrësit është kërkuar të analizojnë opsionet pa potencuar preferencat e tyre. Pjesëmarrësit morën pjesë në takim në cilësi individuale dhe diskutimi është bërë sipas Rregullit Chatham House.

<sup>1</sup> Për raportet e mëhershme të tryezave të rrumbullakëta të organizuara nga CIG lidhur me dialogun e brendshëm, ju lutem vizitoni [www.cigonline.net](http://www.cigonline.net).

<sup>2</sup> Opsionet në vijim kanë dalë nga dialogu i brendshëm: 1. Riintegrimi i Kosovës në rendin kushtetues të Serbisë; 2. Ndarja në baza etnike apo shkëmbimi i territoreve; 3. Ngrirja e konfliktit dhe mbajtja e *status kuo-së*; 4. Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës por vazhdon dialogun me Brukselin për të gjetur një zgjidhje të realizueshme; 5. Një konfederatë ku Kosova bëhet njësi në atë konfederatë; 6. Zgjidhja e çështjeve ekonomike pa zgjidhje politike; 7. Komuniteti i kombeve të Ballkanit; 8. Serbia dhe Kosova hyjnë në BE në të njëjtën kohë, duke lënë mënjanë çështjen e statusit; 9. Negociatat me Shqiptarët e Kosovës nën patronatin e komunitetit ndërkombëtar – KB apo BE-bazuar në një politikë mos-njohje dhe pa nënshkruar marrëveshje të reja; 10. Një shtet i përbashkët i Shqiptarëve dhe Serbëve në Kosovë si bashkëqeverisje e Shqipërisë dhe Serbisë; 11. Njohja e pavarësisë së Kosovës.

Raporti nuk favorizon ndonjërin nga opsionet për zgjidhjen e qështjes së Kosovës. Vetëm ofron një listë të përparësive dhe të metave të katër opsioneve të përshkruara nga pjesëmarrësit e punëtorisë.

## 1. Status kuo

Sipas një studimi të bërë së fundi nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, opsioni më i keq për Serbinë është opsioni i konfliktit të ngrirë ose status kuo-së. Raporti thekson se zgjatja e konfliktit do të rezultonte në emigracion të theksuar dhe rrënim ekonomik dhe të sigurisë. Pjesëmarrësit ishin shumë kundër këtijë opsioni, duke mos parë gati asnjë përparësi por vetëm shumë të meta. Ky opsion është më i keqi nga të katër opsionet.

### *Përparësitë*

- Status kuo-ja mund të ofrojë ndryshimin e shumë nevojshëm të atmosferës aktuale negative dhe helmuese.

### *Të metat*

- Favorizon krimin e organizuar dhe aktivitetet ilegale. Është i dëmshëm edhe për punët e brendshme të Kosovës, sundim të ligjit dhe, zhvillimit demokratik në përgjithësi.
- Zgjat jostabilitetin dhe hap dyer për akterë të tjerë, siq janë Rusia dhe Turqia, të ndërhyjnë në zgjidhje.
- Pengon Serbët në Kosovë duke zgjatur paqartësi dhe ruajtjen e strukturave të krimit të organizuar në veri si dhe duke fuqizuar bashkëpunimin e tyre me struktura kriminale gjetiu në Kosovë.

## 2. Ndarja

Shumë në lidhshimin Serb favorizojnë ndarjen, duke e konsideruar atë si fitoren e parë pas ‘mposhtjeve’ të 1999-tës dhe 2008-tës. Zyrtarët Kosovar janë kundër ndarjes, edhe pse disa e mbështesin këtë opsion me kushtin që të përfshijë shkëmbim terriroresh. Shumë akterë kyq perëndimor mbesin të vendosur kundër një rezultati të tillë, fillimisht për shkak të efektit të mundshëm domino në Ballkan dhe më gjerë. Ky konsiderohet si më së paku i realizueshëm nga të katër opsionet.

### *Përparësitë*

- Është një rregullim i shpejtë potencialisht që ofron një zgjidhje të përhershme nga e cila të dy palët to të përfitonin diçka. Serbia do të përfitonte 10 përqind të territorit të Kosovës. Kosova do të pranonte njohje formale nga Serbia, potencialisht nga pesë mos-njohësit e BE-së, Rusia dhe ndoshta shumë vende anëtare të KB-ve, dhe një perspektivë të qartë drejt BE-së. Disa pjesëmarrës thanë që ndarja përfaqëson një zgjidhje fitimtare për të dyja palët por edhe mund të përshpejtojë krijimin e Shqipërisë së Madhe. Sidoqoftë, shumë thanë që për qytetarët Serbë një Shqipëri e Madhe pa veriun është më e pranueshme sesa një Kosovë e pavarur me veriun.
- Ndarja do të krijonte një stabilitet të brendshëm më të lartë në Serbi.
- Ka shumë gjasa që Rusia do të favorizonte këtë rezultat – duke e konsideruar përfitues për interesat e veta pas-Sovietike – dhe si rrjedhojë të pajtohet për një ulëse në KB për Kosovën.

- Veriu i Kosovës ka potencial të mbetet një zonë konflikti. Shumë thanë që Kosova nuk do të jetë në gjendje ta integroj plotësisht veriu. Ndarja do të eliminonte rrezikun e jostabilitetit afatgjatë.

### ***Të metat***

- Ndarja nuk do të jetë e mundshme pa ndonjë njohje eksplicite të Kosovës nga Serbia prandaj është e pamundur për Beogradin t’iu shmangët këtij hapi të vështirë.
- Nuk e zgjidh problemin. Një numër i konsiderueshëm i serbëve do të mbesin në Kosovë dhe i shqipëtarve në Serbi. Kjo popullsi do të jetë e ndjeshme ndaj konflikteve eventuale ndëretnike.
- Mund të kufizojë të drejtat e serbëve në jugun e Kosovës nëpërmjet një rishikimi eventual të Planit të Ahtisaarit dhe kushtetutës. Shumë thanë që ndarja do të shtynte shumë serbë nga jugu të ikin nga Kosova.
- Do të lejonte Prishtinës të kërkojë së paku pjesë të Luginës së Preshevës dhe të hap rrugë drejt krijimit të Shqipërisë së Madhe.
- Do të shfuqizonte idenë e multikulturalizmit në Kosovë të përkrahur nga komuniteti ndërkombëtar. Do të paraqiste gjithashtu disfatë për BE-në, parimet e sajë dhe përpjekjet e saja dekadëshe të ndërtimit të një demokracie multietnike në Kosovë. Kjo gjithashtu do të nënkuptonte që procesi i Brukselit ka qenë humbje kohe.
- Mund të shpie tek një konflikt i armatosur.
- Mund të shkaktojë efektin domino. Ndarja potencialisht do të ketë efektin e përhapjes në vendet fqinje – Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, dhe Maqedoni. Një Shqipëri e Madhe, Serbi e Madhe, dhe madje një Kroaci e Madhe mund të dalin si pasojë.
- Ndarja mund të përçaj edhe më shumë të dy shoqëritë dhe të pamundësojë normalizimin e marrëdhënieve.
- Nuk ruan simbolet më të rëndësishme të identitetit në Serbi dhe nuk mbron gjithë serbët. Manastiret më të rëndësishme dhe vendet e shenjta dhe shumica e serbëve të Kosovës janë në jug.
- Ndarja do të kishte pasojat negative për Kishën Ortodokse Serbe (KOS).
- Në qoftë se ndarja nënkupton shkëmbim territoresh, mund ta rrezikojë kontrollin e Serbisë mbi anën jugore të Korridorit 10 (Autostrada Beograd-Selanik) që aktualisht kalon nëpër komunën e Preshevës me shumicë Shqiptare.

### **3. Njohja de juro**

Shumë folës thanë që njohja de juro është më pak e mundshme, madje edhe nëse kushtëzohet me anëtarësim të Serbisë në BE, së paku për njëzet vitet e ardhshme. Sidoqoftë, disa folës thanë që njohja mund të ndodh edhe tani, me disa opinione publike të orkestruara nga qeveria, por që pasojat do të ishin negative për Serbinë, duke krijuar ndarje të brendshme. Një numër i folësve thanë që njohja mund të ndodh vetëm me ndarjen e veriut si shkëmbim.

Njohja mund të ndodh pas negociatave gjithpërfshirëse pas të cilave të dy palët bien dakord që synimi i procesit është njohja dhe, pastaj të fillohet me negociatat që do të duhej të përmbylleshin deri në vitin 2023. Negociatat duhet të sigurojnë se “serbët e Kosovës ndihen sikur të ishin duke jetuar në Serbi” dhe se kjo duhet të arrihet nëpërmjet ndryshimeve në

kushtetutën e Kosovës e cila lejon krijimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë serbe me fuqi ekzekutive në fushën e shëndetësisë, kulturës dhe zhvillimit ekonomik dhe dhënien e territorit shtesë manastireve dhe kishave ortodokse serbe.

### ***Përparësitë***

- Njohja *de juro* do të qartësonte marrëdhëniet në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Do të siguronte një zgjidhje të qartë dhe do të përfundonte konfliktin.
- Mund t'i ndihmojë Serbisë në negociatat me BE-në dhe si rrjedhojë t'iu lejojë qytetarëve të Serbisë të pranojnë ndarjen finale të Kosovës. Shanset e Serbisë për anëtarësim në BE janë ndoshta më të mirat me këtë opsion. Me fjalë të tjera, njohja mund të trajtohet pozitivisht përderisa “përfaqëson një përparësi në procesin e integritit të Serbisë në BE”.
- Njohja do të rezultojë në demokratizim më të madh të të dy shoqërive. Do të lejonte garë më të madhe politike si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, më shumë liri mediale, dhe potencialisht të ndihmojë demokratizimin në përgjithësi të shoqërive. Mund të shpie gjithashtu edhe në ndryshime në udhëheqësitë e Serbisë dhe Kosovës. Shumë thanë që udhëheqja aktuale është e favorizuar nga komuniteti ndërkombëtar vetëm sepse “prodhojnë” dialogun e mbështetur nga BE-ja.
- Përderisa një njohje e tillë do të nënkuptonte përfundim të konfliktit, ajo poashtu do të lejonte ballafaqimin me të kaluarën në një mënyrë më të suksesshme dhe do të ofronte bazë më të mirë për pajtim.
- Kosova do të bëhet anëtare e Kombeve të Bashkuara (KB), Këshillit të Evropës dhe OSBE-së, përveq organizatave të tjera ndërkombëtare, duke ofruar adaptimin dhe zbatimin e normave përgjithësisht të pranura për të drejtat e njeriut dhe minoriteteve në Evropë.

### ***Të metat***

- Njohja mund të shkaktojë ndarje të brendshme. Kosova është e rëndësishme në nivel emocional si një simbol i kombit serb dhe vetëm disa mbështesin njohjen e pavarësisë së Kosovës. Njohja mund të krijojë frustrim afat-gjatë dhe “psikozë kolektive”, diqka ngjashëm me sindromën Trianon në Hungari që edhe pas 100 vitesh pas Luftës së Parë Botërore ende është prezente. Njohja me siguri do të krijonte ndarje të thella përbrenda shoqërisë “për 100 vitet e ardhshme”. Serbia dhe Kosova do të bëheshin rezervuar i jostabilitetit në rajon, e që do të ishte vështirë e kontrollueshme. Prandaj, kjo njohje do të bëhej burimi i konfliktit, në vend se të ishte burim i zgjidhjes që qëndrushme. Për një zgjidhje të suksesshme, nevojitet një proces më i gjatë dhe më gjithpërfshirës, së paku deri më 2024.
- Çfardo njohje e Kosovës sjell me vete pyetjen se çfarë do të përfitojë Serbia. Integrimi në BE nuk mund të konsiderohet si një çmim i mjaftueshëm. Anëtarësimi në BE nuk është garanci me njohjen. Anëtarësimi është meritë ndërsa Serbia duhet të zgjidh shumë çështje tjera përveq Kapitullit 35. Nuk është e qartë se çfarë përfiton Serbia me këtë opsion. Pa një këmbim të qartë dhe të prekshëm, sigurisht to të ishte e pamundur ti bindim qytetarët e Serbisë të aprovojnë një njohje të tillë. Disa nga pjesëmarrësit thanë që një opsion i tillë nuk është i mundshëm për qeverinë aktuale pa ndarje të veriut apo shkëmbim terriore. Të tjerët thanë që është e mundshme dhe do duhej të bëhej me kufijtë aktual.
- Kjo zgjidhje nuk eliminon mundësinë e një Shqipërie të Madhe në vitet e ardhshme.
- Njohja nuk do të rezultojë në normalizim të menjëhershëm në mes të dy shoqërive. Çështja më me rëndësi nuk do të zgjidhet me njohje: burimet e konfliktit, situatë e serbëve në Kosovë, dhe çështja e perspektivës Evropiane për Kosovën.

- Njohja mund të fuqizojë pushtetin e elitës aktuale në Beograd dhe Prishtinë. Tensioni si në Kosovë dhe në Beograd mund të rezultojë me shtrengim të pushtetit nga elita aktuale, prishje të sundimit të ligjit dhe lirisë së medias.
- Njohja do të dobësojë pushtetin aktual në Serbi për të mbrojtur statusin e serbëve të Kosovës. Kjo është e rëndësishme sepse dëri më tani Prishtina nuk ka qenë e gatshme t'i integrojë serbët. Derisa disa pohuan se Kosova do të fillonte respektimin e ligjeve të veta posa të pranonte njohjen, duke mos konsideruar serbët vendor si instrument të beogradit, të tjerët thanë që kushtetuta dhe ligjet mund të ndryshohen pavarësisht kufizimeve ligjore.

#### **4. Njohja de fakto**

Ky opsion presupozon se Serbia nënshkruan marrëveshje gjithpërfshirëse ligjore të detyrueshme me Kosovën ashtu siç është përcaktuar nga BE-ja, pa njohur de juro shtetin e Kosovës. Si pjesë e marrëveshjes, Serbia hap rrugë që Kosova të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, veqanërisht në KB, dhe e trajton de fakto si vend të pavarur pa e njohur zyrtarisht. Shumica e folësve u pajtuan që anëtarësimi i Serbisë në BE është i mundshëm pa njohje zyrtare të Kosovës.

##### ***Përparësitë***

- Pasojat e paqes shoqërore në Serbi do të ishin më pak dramatike sesa në rast të njohjes eksplicite. Serbia do të ndihej jo humbëse pas marrëveshjes.
- Ky opsion do të rezultonte në pasoja shumë më pak të dëmshme për secilën shoqëri, pasi që do t'i lejonte Prishtinës të përfitojë legjitimitet më të madh ndërkombëtar, derisa lejoni Serbinë të mos heq dorë de juro nga Kosova dhe të përparojë me integrimin e saj në BE.
- Serbia do të përfitonte nga kjo zgjidhje më shumë sesa nga procesi aktual i Brukselit. Kosova, në këmbim të kësaj, do të finalizonte integrimin e veriut dhe të fuqizonte sovranitetin. Serbët në Kosovë do të përfitonin gjithashtu pasi që Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe me gjasë do të krijohet.

##### ***Të metat***

- Kjo nga Kosova dhe shumica e Perëndimit do të shihej si një zgjidhje e përkohshme dhe konflikti do të vazhdojë.
- Situata nuk do të ndryshonte në mënyrë dramatike, problemi nuk do zgjidhet komplet, dhe një nivel i caktuar i frustrimit në të dy anët do të mbetet. Serbët e Kosovës do të vazhdonin të ndiheshin të lënë në harresë. Përfituesit më të mëdhenj do të ishin elitat aktuale në pushtet në Prishtinë dhe Beograd. Do të jenë në pushtet për të zbatuar marrëveshjen dhe të vazhdojnë procesin për zgjidhjen e problemit. Disa thanë që me njohje eksplicite nuk do të kishte Asociacion/Komunitet të komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive pasi që Prishtina nuk do të pajtohet ta themelojë atë në këmbim të një njohje implicite.
- Përderisa do të ishte më e lehtë për Kosovën të anëtarësohet në një numër të organizatave ndërkombëtare, disa pjesëmarrës pohuan se njohja implicite nuk do të garantonte ulëse në KB. Synimi i Prishtinës është ulësja në KB, si rrjedhojë ky opsion nuk favorizohet nga ata. Ky opsion nuk do të ndihmonte as që Kosova të arrijë ambiciet e saj për një perspektivë të qartë në BE dhe eventualisht anëtarësim në BE. Njohja implicite do të jepte argument Spanjës dhe pjesës tjetër të mos-njohësve të BE-së të mbesin të palëkundur në pozitën e tyre të mos njohjes së Kosovës.

- Ky opsion me gjasë do të ofronte edhe më pak siguri lidhur me vet të ardhmen e Serbisë në anëtarësimin e sajë në BE pasi që vendi do të shihej si i tillë me kufijë të padefinuar.
- Ky opsion ka shumë gjasë që të vazhdojë me fatin e njejtë të marrëveshjeve tanimë të nënshkuara në Bruksel dhe të mos zbatohet asnjëherë.

## **Pjesëmarrësit në punëtori**

**Nikola Burazer**, Drejtor Ekzekutiv, Ballkani Evropan Perëndimor

**Gordana Delic**, Drejtoreshë, Fondi Ballkanik për Demokraci

**Ivan Djuric**, Kordinator i Programit, Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut

**Dusan Milenkovic**, Kordinator i Programit, Fondacioni Westminster për Demokraci

**Petar Miletic**, Kolumnist

**Natasa Petrovic**, Zyrtare e Lartë e Programit, Trusti Ballkanik për Demokraci

**Stefan Surlic**, Asistent Mësimor, Fakulteti i Shkencave Politike, Universiteti i Beogradit

**Aleksandra Sanjevic**, Zyrtar i Programit, Fondacioni për Shoqëri të Hapur

**Uros Todorovic**, Grupi Punues për Dialog të Brendshëm, Qeveria e Serbisë (vëzhgues)

**Shpetim Gashi**, Zëvendës President, Këshilli për Qeverisje Gjithpërfshirëse

**Igor Novakovic**, Përfaqësues në Serbi, Këshilli për Qeverisje Gjithpërfshirëse

**Alex Roinishvili Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Gjithpërfshirëse